



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	16.04.2026	27.04.2026	2026/0230

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 10.04.2026, OE “G-PROJECT”- Prizren, ka parashtruar ankesë me nr: **2026/0230**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “TONI O.P & 100 % Design SHPK], lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Nderhyrje restauruese dhe konservuese ne asetet e Trashëgimise Kulturore ne Rajonin e Prizrenit LOT I Shkolla e mesme Ryzhdiye ne Prizren dhe LOT II Shkolla e vjeter e fshatit Mushnikove” me nr. të prokurimit: “207-25-9810-5-1-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **Vlera e parashikuar për LOT I është 676,448.80€**

Vlera e parashikuar për LOT II është 289,678.00€

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Ligji i Prokurimit Publik

- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

- Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës
- Neni 11 Informatat Sekrete Afariste
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 70 Standardet për Sigurimin e Cilësisë Rregullorja e Prokurimit Publik
- Neni 7 Informatat sekrete afariste dhe qasja në dokumente Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative
- Neni 47 – Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar
- Neni 48 – Arsytimi i një akti administrativ me shkrim
- Neni 52 – Paligjshmëria e aktit administrativ

I. Hyrje

1. Autoriteti Kontraktues Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (tutje: Autoriteti Kontraktues) me datën 14.11.2025, ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Prizrenit LOT I Shkolla e mesme Ryzhdije në Prizren dhe LOT II Shkolla e vjetër e fshatit Mushnikovë” me numër të prokurimit: 207-25-9810-5-1-1. Data e fundit për dorëzimin e ofertave ishte data 24.11.2025.

2. Operatori ekonomik G-Project ShPK (tutje: Ankuesi) brenda afatit të përcaktuar në dosje të tenderit ka dorëzuar ofertë për pjesët 1 dhe 2 të këtij aktiviteti të prokurimit, me anë të së cilës ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe ato të pranueshmërisë. Me datën 24.11.2025 është bërë hapja e ofertave dhe leximi i çmimeve.

3. Me datën 16.03.2026 është bërë publikimi i Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me anë të së cilit kemi kuptuar se oferta e Ankuesit ishte vlerësuar si e pasuksesshme në të dy pjesët, ndërsa operator i rekomanduar ishte grupi i operatorëve Toni OP dhe NN 100% Design ShPK. 7. Në kundërshtim me afatet e përcaktuara ligjore, me datën 30.03.2026 Autoriteti kontraktues ka nxjerrë vendim mbi shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim të datës

4. Duke e ditur se ky grup i operatorëve ka një numër të madh të kontratave në zbatim dhe rrjedhimisht nuk mund të përmbush kriterin për mos angazhim të të njëjtit staf të licencuar edhe në dy projektet ekzistuese, Ankuesi ka kërkuar qasje në dokumente të këtij grupi të operatorëve. Me datën 17.03.2026 Autoriteti kontraktues ka siguruar qasjen e pjesshme në dokumente zyrtare, meqë rast janë ofruar disa dokumente si: i) deklarata nën betim, ii) marrëveshja e konsorciumit, iii) dokumentet e ARBK dhe TVSH, iv) sigurimi i ofertës, v) paramasa, vi) lidhja e ofertës, vii) raporti i vlerësimit të komisionit, viii) qarkullimi financiar dhe ix) Lista e kontratave dhe referencat (pjesërisht).

5. Ankuesi nga dokumentet e siguruar në qasje përkatësisht nga lidhja e ofertës ka vërejtur se nuk i ishte dhënë qasje në grupin e dokumenteve: i) “5.1. referenca, raporte pranimi teknik, ii)

5.1.2. referenca, raporte pranimi teknik, iii) Iso Standarde, iv) Lista e stafit profesional & mbështetës, v) Stafi profesional, 7.2. stafi teknik, vi) stafi mbështetës, vii) punëtorët mbështetës, viii) lista e mjeteve.

6. Me dokumentet që kishte në dispozicion dhe përshkak të mos ofrimit të qasjes së plotë në dokumente zyrtare, Ankuesi me datën 23.03.2026 ka paraqitur një Kërkesë për rishqyrtim, duke argumentuar shkelje të nenit 10 sa i përket qasjes në dokumente zyrtare dhe shkelje të nenit 59 sa i përket procedurave të vlerësimit përkatësisht shpërblimit me kontratë operatorit që nuk i plotëson kriteret e përzgjedhjes.

7. Në kundërshtim me afatet e përcaktuara ligjore, me datën 30.03.2026 Autoriteti kontraktues ka nxjerrë vendim mbi shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 23.03.2026 me anë të së cilës ka refuzuar si kinse të pabazuar kërkesën për rishqyrtim dhe ka vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

ii. Baza ligjore për aprovimin e Ankesës

Mos-ofrimi i qasjes së plotë në dokumente

8. Siç është sqaruar në më lartë, autoriteti kontraktues nuk ka respektuar Nenin 10 të Ligjit për Prokurimin Publik, në të cilin 10 [Mjetet për promovimin e transparencës] në të cilin garantohet e drejta e operatorëve ekonomik pjesëmarrës për të pasur qasje në dokumentet zyrtare të operatorëve konkurrent. Autoriteti kontraktues nuk ka arsyetuar se a është aprovuar pjesërisht apo plotësisht kjo kërkesë dhe mbi cilën bazë cilës dispozitë i është siguruar mbrojtje e këtyre informacioneve. Neni 11 i Ligjit të Prokurimit Publik ka përcaktuar qartë se cilat informata mund të jenë dhe të mbrohen si sekrete afariste. Në anën tjetër me Rregulloren e Prokurimit Publik neni 7 par. 7.6.2. ka përcaktuar se ato informacione duhet të pastrohen nga dokumentet dhe pjesa tjetër e dokumentit duhet të jetë publike për qasje të operatorëve të interesuar.

9. Në rastin përkatës, autoriteti kontraktues ka dështuar të përmbush detyrimet e veta pozitive në raport me sigurimin e transparencës për operatorët e interesuar, të cilët kërkojnë të shohin nëse vlerësimi i ofertave ishte në përputhje me Ligjin dhe kërkesat e përzgjedhjes për arsye se: i) nuk është dëshmuar se operatori i rekomanduar i ka markuar në platformën e eprokurimit këto dokumente si sekrete afariste, ii) nuk është dëshmuar se Autoriteti kontraktues ka nxjerr një akt administrativ/vendim me të cilin e aprovon këtë kërkesë pjesërisht apo plotësisht dhe iii) nuk është përgatitur versioni i pastruar i ofertës me largimin e informatave sekrete afariste.

10. Autoriteti kontraktues përveç se ka detyrime të mbrojtë sekretet afariste ndaj operatorit të rekomanduar për kontratë, i njëjti po ashtu ka detyrimin e transparencës ndaj operatorëve të tjerë të cilët duhet të kenë qasje dhe të binden se procesi i vlerësimit ishte i drejtë dhe i ligjshëm. Autoriteti kontraktues para se të nxjerr një vendim për mbrojtjen e sekretit afarist duhet të aplikoj testin e përcaktuar në nenin 11 të Ligjit të Prokurimit Publik, i cili kërkon që të mbrohen vetëm ato informatat të cilat: “bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik”.

Në rastin konkret informatat e mbrojtura ndërlidhen me stafin, referencat për punë të ngjashme, standardet Iso dhe makineritë/pajisjet. Asnjë nga këto informata nuk përmbushin

kërkesat e përcaktuara në nenin 11 të Ligjit, pasi që publikimi eventual i tyre, nuk do ti shkaktonte asnjë operatori asnjë lloj dëmi. Kjo pasi që fillimisht standardet Iso nuk mund të mbrohen si sekrete afariste pasi që bëjnë pjesë tek kërkesat e ligjit për nenin 70 [standardet për sigurimin e cilësisë] dhe nuk kanë lidhje me nenin 68 dhe 69 për të cilat lejon ligji mbrojtjen. Si të tilla është dashur që të ofrohen për qasje në kërkesën e Ankuesit.

11. Tutje, një pjesë e referencave na janë ofruar për qasje pjesërisht në referencat e operatorit Toni, mirëpo siç shihet nga lidhja e ofertës, operatori i rekomanduar ka dorëzuar 18 follder në formatin rar, ndërsa Ankuesit i janë ofruar vetëm 9 nga këto follder, duke i mohuar qasjen e gjysmës tjetër të dokumenteve prej 9 follderash.

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	1 Deklarata nen Betim.rar
2.	1.1 Deklarata per themelimin te grupit.rar
3.	2 ARBK & TVSH.rar
4.	3 Licensa B2.rar
5.	4 Qarkullimi.rar
6.	5 Lista e Kontratave & Referencat.rar
7.	5.1 Referenca, Raporte pranimi teknik.rar
8.	5.1.2 Referenca, Raporte pranimi teknik.rar
9.	6 ISO Standarte.rar
10.	7 Lista e Stafit Profesional & Mbeshtetes.rar
11.	7.1 Stafi Profesional.rar
12.	7.2 Stafi Teknik.rar
13.	7.3 Stafi Mbeshtetes.rar
14.	7.4 Puntoret Mbeshtetes.rar
15.	8 Lista e Mjeteve.rar
16.	9 Deklaratat.rar
17.	10 Sigurimi.rar
18.	11. Ofertat.rar

Foto 1: Dëshmia nga lidhja e ofertës për dokumentet e dorëzuara. Pjesa e dokumenteve të hijezuara me ngjyrë të gjelbërt është ofruar qasje në dokumente, ndërsa pjesa e hijezuar me të kuqe nuk është ofruar qasje në dokumentet zyrtare.

12. Vlen të theksohet se për këta 9 follder në të cilët nuk është siguruar qasje, as e kufizuar dhe as e plotë, nuk ka asnjë mbështetje në nenin 11 të ligjit që të kategorizohen si dokumente të mbrojtura si sekrete afariste. E vetmja mbrojtje që i jepet operatorit në këtë rast është mbrojtja nga ankesat dhe kërkesat për rishqyrtim të cilat do të identifikonin mospërputhjet e ofertës me kërkesat e dosjes së tenderit. Po ashtu konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues duke mos na ofruar qasje në të gjitha dokumentet e ofertës së operatorit të rekomanduar, na ka pamundësuar dorëzimin e një kërkesë për ankese të mirë argumentuar dhe të plotë.

13. Në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti kontraktues pretendon se

ka respektuar nenin 11 edhe pse nuk ka nxjerr vendim në lidhje me kërkesën për ruajtje të sekretit afarist. Ajo që është edhe më shqetësuese është mbrojtja e certifikatave ISO të cilat hyjnë në kuadër të kërkesave nga neni 70 i Ligjit dhe nuk mund të mbrohet në asnjë rast si sekrete afariste. Autoriteti kontraktues pretendon se për faktin se këto kërkesa të dosjes kanë qenë të listuara tek mundësitë teknike dhe ose profesionale, të njëjtat hyjnë në kategorinë e Nenit 68 dhe 69 të Ligjit të Prokurimit Publik. Mirëpo, Ankuesi thekson se pavarësisht se në cilën pjesë të dosjes bëhet kërkesa për këto certifikata, dosja e tenderit nuk mund të konsiderohet si ndryshim i dispozitave ligjore. Një përgjigje e tillë e Autoritetit kontraktues tregon më së mirë insistimin absurd për të mos ofruar transparencë edhe kur kjo është detyrim ligjor i cili nuk lejon interpretim.

Përdorimi i stafit në kontrata të tjera

14. Në dosjen e tenderit, tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kriteri numër 7, është kërkuar: “Kriteri numër 7. O.E. duhet të siguroj nuk ka me shume se tri kontrata aktive me MKRS-ne të natyrës së njëjtë, respektivisht në planin dinamik të punës nuk mund të jetë i njëjti arkitekt i licencuar ose mjeshtër i licencuar i angazhuar në më shumë se tri kontrata tjera të natyrës së njëjtë.” Në ndërkohë si dëshmi është kërkuar: “7.Nëse vlera e kontratës në të cilën stafi i licencuar është i angazhuar ka vlerë nën 100,000.00 euro ky kriter nuk zbatohet. Nëse O.E. konkurren në disa projekte restauruese në planin dinamik të punës nuk mund të figurojë i njëjti arkitekt i licencuar, ose mjeshtër i licencuar në më tepër se tri kontrata i angazhuar në të njëjtën kohë (njëjtat data kalendarike).”

15. Tutje në dosjen e tenderit është kërkuar që: “Vërejtje: Nese OE apo GRO ofertojnë në të dy LOT- et ofertimi duhet të bëhet sipas rregullave të nenit 18.5 dhe 18.9 të Rregullores nr. 002/ 2024 për Prokurimin Publik”.

16. Nga sigurimi i dokumenteve dhe informatave në bazë të kërtimeve në platformën e e-Prokurimit dhe mënyrat sekondare të kërkit të vërehet se operatori i rekomanduar për kontratë, ka edhe kontrata të tjera në implementim që dot ë thotë se i njëjti nuk ka dhënë deklaratë të saktë se nuk ka stafin e angazhuar në projektet e tjera.

17. Sipas informatave që ka ankuesi operatorët e rekomanduar për këtë kontratë janë duke zbatuar këto kontrata aktive me Autoritetin Kontraktues:

N.N. 100% Design SHPK:

a. “Faza e dytë - Restaurimi i Hamamit të Gazi Mehmet Pashës - Prizren”, me Nr. 207-23-14006-5-2-1/C402 (207-23-146-5-2-1)

b. “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese – Ish Konsullata Austro Hungareze në Prizren”, me Nr. 207-23-10029-5-2-1/C360 (207-23-087-5-2-1)

c. “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në Rajonin e Prizrenit - Faza e parë” Lot II Ndërhyrje restauruese në shtëpinë-kullë të Hajrulla Çantës, me Nr. (207 25-4876-5-1-1)/C538 (207-25-053-5-1-1)

d. LOT IV Konservimi dhe restaurimi i shtëpisë së banimit të Kolë pashkut, Stubëll – Viti, me nr. Prokurimi 207-25-5051-5-1-1/C547 (207-25-060-5-1-1)

e. Restaurimi i muzeut të viktimave të njohur si muzeu i masakres në lagjen e boshnjakeve, Mitrovicë e Veriut (207-25-9571-5-2-1)

f. Lot II Adaptimi dhe revitalizimi i hapësirave të teatrit në Kompleksin e Pallatit të Rinisë dhe të Sporteve me nr. Prokurimi 207-25-3927-5-1-1/C566

g. Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në objektet e Trashëgimisë Kulturore në gjithë Republikën e Kosovës - Faza e katërt; Lëndët e prokurimit - Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në objektet e Trashëgimisë Kulturore në gjithë Republikën e Kosovës - Faza e katërt në Rajonin e Prishtinës, me numër 207 24-10543-5-1-1.

Toni OP:

a. “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në Rajonin e Prizrenit dhe Rajonin e Gjakovës - Faza e parë” Lot II Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në shtëpinë e familjes Koçbashliu me nr. 207-25-7857-5-2-1/C563 (207-25-093-5 2-1)

b. LOT 3 :konservimi restaurimi i shtëpise së Qehajve Peje 207-25-8268-5-2 1/C597 (207-25-101-5-2-1)

c. Nderhyrje restauruese dhe konservuese në shtëpine të Ymer Elshanit-Drenas me nr. 207-25-5803-5-2-5/C545 (207-25-064-5-2-5)

d. Renovimi i Galerisë Kombëtare

e. Restaurimi i Kulles së Tosun Beut – Gjakovë, me nr. prokurimi 207-25-602-5 2-1/C498

18. Po ashtu nga Autoriteti kontraktues kemi kërkuar që të verifikoj edhe kontratat e tjera potenciale që këta dy operator mund të kenë në realizim e sipër për të vërtetuar nëse kemi të bëjmë me mbivendosje të shumëfishtë të stafit të njëjtë e që do të binte në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit.

19. Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim në këtë pikë nuk ka mohuar se operatorët e rekomanduar janë të angazhuar në kontrata të tjera dhe kanë të njëjtin staf të angazhuar, por ka tentuar që kësaj ti eskivoj duke keqinterpretuar kërkesën e dosjes së tenderit, se bëhet fjalë vetëm për kërkesa për kontrata mbi 100,000 Euro ku sipas Autoritetit kontraktues është vërtetuar se nuk është i njëjti staf. Mirëpo, Autoriteti kontraktues nuk ka sqaruar se cilat kontrata i kanë aktualisht këta operator, me cilin staf i zbatojnë ato, cila është vlera e tyre dhe si i plotësojnë kushtet e dosjes së tenderit. Në mungesë të një arsytimi të tillë, ky vendim ngjanë më shumë në tentim për mbulim të vlerësimit të gabuar të ofertave sesa arsyetim i plotë sipas dispozitave 47, 48 dhe 52 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Mos-plotësimi i deklaratave nga anëtarët e konsorciumit

20. Sipas marrëveshjes së konsorciumit, anëtarët e konsorciumit janë pajtuar që punët të ndajnë 90 përqind për liderin dhe 10 përqind për anëtarin e konsorciumit. Që do të thotë se kanë përgjegjësi të ndarë për zbatimin e kontratës në përqindje të caktuar. Megjithatë, anëtarët e konsorciumit nuk ka dorëzuar asnjë nga deklaratat e kërkuara sipas dosjes së tenderit në lidhje

me mosangazhimin e stafit në më shumë se tri kontrata të tjera apo në deklaratat e tjera që janë kërkuar sipas dosjes së tenderit.

21. Për më tepër për shkak të mungesës së qasjes në dokumente zyrtare, nuk e kemi të njohur nëse i njëjti ka certifikimet ISO siç janë kërkuar në dosjen e tenderit. Autoriteti kontraktues në lidhje me këtë pikë vetëm ka theksuar në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim se grupi i plotëson kushtet, mirëpo pa e dokumentuar këtë sipas kërkesave të Ligjit për Prokurimin Publik dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Nuk ka asnjë arsye ligjore apo tjetër që dokumentet si certifikatat ISO apo deklaratat e anëtarëve të konsorciumit të mos ofrohen për qasje, me pretendimin se po mbrohen sekretet afariste. Sekretet afariste mund të jenë të ndërlidhura me metoda të kryerjes së punëve, raporteve me klient por jo me certifikata të cilësisë dhe dokumente të tjera që nuk përmbushin kushtin për mbrojtje sipas nenit 11 të LPP. Marrëveshja jo e plotë e konsorciumit

22. Marrëveshja e konsorciumit, nuk i plotëson kushtet e dosjes së tenderit dhe Rregullores së prokurimit, pasi që nuk është e detajuar për të treguar saktë se çka do të bëjë secili anëtar dhe cilat janë përgjegjësitë e ndara. Anëtarët vetëm kanë ndarë në përqindje pjesët e realizimit të kontratës po pa i sqaruar detyrat specifike të secilit dhe afatet e zbatimit të këtyre detyrimeve. Autoriteti kontraktues në lidhje me këtë pretendim ankimor, ka theksuar se për Autoritetin ndarja në përqindje edhe pse nuk është e definuar se kush çfarë do të bëjë, është e mjaftueshme.

Megjithatë, ky trajtim kaq preferencial i kësaj oferte në kundërshtim me rregullat e zbatueshme të prokurimit publik, bie ndesh ndër të tjera edhe me vet parimet e Ligjit të Prokurimit Publik, veçanërisht kur kihet parasysh se këto mungesa mund të reflektohen negativisht në fazën e zbatimit të kontratës.

Prandaj, duke marrë parasysh të gjitha argumentet e sipërcekura, me respekt i kërkojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit, që pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit të nxjerr këtë:

VENDIM

I. APROVOHET si tërësisht e bazuar Ankesa e operatorit ekonomik G-Project SH.P.K. të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e avokatëve RZZ Law me seli në Rruga Ferid Curri, Prishtinë.

II. ANULOHET Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 16.03.2026 dhe lënda i kthehet komisionit vlerësues për RIVLERËSIM.

III. DETYROHET autoriteti kontraktues që operatorit ekonomik ankues t’ia paguaj shpenzimet e procedurës së ankesës sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

KRITERET PËR VLERËSIM

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “G-PROJECT”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Prizrenit LOT I Shkolla e mesme Ryzhdije në Prizren dhe LOT II Shkolla e vjetër e fshatit Mushnikovë” me numër të prokurimit: “207-25-9810-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i>
		Kriteri numër 1. ISO 9001-2015 – Sistemi i menaxhimit të cilësisë	1. ISO-standardet e paraqitura për plotësim duhet të dëshmojnë si dokumente valide.
		Kriteri numër 2. Caktimi i Menaxherit të kontratës	2. Vendimi për përcaktimin e menaxherit të kontratës, i cili duhet të jetë Master ose Inxhinier i Arkitekturës ose i Ndërtimtarisë-konstruktiv. Vendimi duhet të përmbajë të dhënat bazike mbi procedurën aplikuese (Emrin e Autoritetit, Emërtimin e procedurës, numrin e prokurimit). Menaxheri i kontratës duhet të prezantojë a. Diplomën universitare. b. Kontratën e punës ose parakontratë (të nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE). c. Dëshmi për përvojë të punës së paku 5 vite në fushën e trashëgimisë kulturore ose të punëve të ngjashme (të dëshmohe me CV të nënshkruar nga i angazhuari). d. Së paku një referencë të punës në menaxhim të kontratave – mbikëqyrje të implementimit të projekteve të ngjashme; Së paku njëri nga stafi i angazhuar, qoftë menaxheri i kontratës qoftë njëri prej inxhinjerëve nga lista e stafit profesional duhet të jenë të licencuar me licencë A1. Në rast të posedimit të Licencës A1 - për hartimin e projekteve për konservim restaurim dhe mbikëqyrje të implementimit në fushën e trashëgimisë kulturore të paluajtshme, duhet të prezantohet vetëm kopja e licencës ose kopja e vendimit të Bordit të Licencimit që është i licencuar në kategorinë A1; Kontratën ose parakontratë me O.E. - të nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE; dhe së paku një referencë të punës në menaxhim të kontratave – mbikëqyrje të implementimit të projekteve të ngjashme.
		Kriteri numër 3. Lista e stafit profesional 3.1 Një (1) Inxhinier i diplomuar i arkitekturës (ose Master) 3.2. Një (1) Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë konstruktiv (ose Master) 3.3. Një (1) Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (ose Master) drejtimi hidroteknik	3. E gjithë lista e stafit të kërkuar në kërkesën numër 2 nga Autoriteti kontraktues duhet të ketë a. Diploma universitare. b. Kontrata e punës ose parakontratë (e nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE). c. Dëshmi për përvojë të punës së paku 5 vite në fushën e trashëgimisë kulturore ose punë të ngjashme (të dëshmohe me CV të nënshkruar nga i angazhuari) për pikën 3.1 dhe 3.2; dëshmi për përvojë të punës së paku 2 vite në fushën e trashëgimisë kulturore ose punë të ngjashme (të dëshmohe me CV të nënshkruar nga i angazhuari) për pikën 3.3 dhe 3.4. d. Dëshmi për së paku një

		referencë të punës që ndërlidhet me njërin nga natyrat e punës në restaurim ose konservim ose renovime të objekteve të trashëgimisë kulturore, përjashtimisht pikave 3.2, 3.3, dhe 3.4 ku nuk kërkohet dëshmi.
	Kriteri numër 4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një listë të vulosur dhe të nënshkruar, ku duhet të përmbajë së paku 24 punëtorë profesional dhe mbështetës. Lista e paraqitur duhet të përmbajë të dhënat Emri dhe mbiemri, të dhënat personale, eksperiencia dhe funksioni brenda kompanisë apo punët që do t'i kryejë në projekt 4.1. Së paku 1 (një) - Teknik të ndërtimtarisë 4.2. Së paku 1 (një) Mjeshtër konservator druri (Licenca A2-2) 4.3. Së paku 1 (një) Mjeshtër konservator guri (Licenca A2-1) 4.4. Së paku 1 (një) Konservues/Restaurues i materialeve të tjera ndërtimore sipas fushës specifike të specializuar (Licenca A2-3) 4.5. Së paku 10 punëtorë në punë të ndryshme, si p.sh. shtrues pllakash, suvatues, instalues, mjeshtër kulmi, llamarinë punues, saldues, etj. 4.6. Së paku 10 punëtorë fizik.	Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një listë të vulosur dhe të nënshkruar, ku duhet të përmbajë së paku 24 punëtorë teknik profesional dhe mbështetës. Lista e paraqitur duhet të përmbajë të dhënat si Emri dhe mbiemri, të dhënat personale, eksperiencia dhe funksioni brenda kompanisë. 1.Për stafin 4.1 Duhet të paraqiten diplomat e shkollimit të mesëm. Duhet të kenë se paku 3 vite përvojë pune (të dëshmohet me CV të nënshkruar nga punëtori) dhe secili duhet të paraqesë dëshmi që ka së paku një referencë në trashëgimi kulturore ose punë të ngjashme. Kontrata e punës (e nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE). 2.Për stafin numër 4.2, 4.3 dhe 4.4 Kontrata e punës ose parakontratë (e nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE) dhe kopjet e licencave përkatëse A2-1, A2-2, A2-3 ose kopjet e vendimit të Bordit të Licencimit. 3. Për stafin numër 4.5 duhet të kenë se paku 3 vite përvojë pune (të dëshmohet me CV të nënshkruar nga punëtori) dhe Kontrata e punës ose parakontratë (e nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE). 4. Për stafin numër 4.6 duhet të paraqiten Kontratat e punës ose parakontratat (e nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE).
	Kriteri numër 5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një Listë të pajisjeve që nevojiten për projektin në fjalë (e që duhet të jenë) 5.1. Kaminonetë – 2 copë 5.2. Kamion kiper me kran me peshë bartëse deri 10 ton – 1 copë 5.3. Kamion kiper me kran me peshë bartëse deri 5 ton – 1 copë 5.4. Skele – platformë me gjerësi min 300 m² 5.7. Një Gjenerator (Agregat).	5. Dëshmitë për listën e pajisjeve; a. Të gjitha pajisjet duhet të jenë në pronësi të aplikuesit dhe në rast të marrjes me qira (duhet të kenë kontratë për huazim – marrje me qira e cila kontratë duhet të jetë valide për projektin në fjalë). b. Për artikujt 5.1, 5.2 dhe 5.3 duhet të kenë librezat valide. c. Të gjithë artikujt (përveç atyre motorike) të dëshmohen edhe me Faturën e blerjes.
	Kriteri numër 6. O.E. duhet të dorëzojë me shkrim deklaratën që e ka kuptuar tenderin (shpalljen) dhe ka siguruar materialet dhe paisjet e kërkuara në tender.	6. O.E. duhet të dorëzojë së bashku me dokumentet tjera për aplikim në tender edhe një deklaratë të nënshkruar dhe vulosur se i ka të qarta kërkesat (materialet, paisjet, veglat, orenditë,...) e paramasës dhe parallogarisë në tender.
	Kriteri numër 7. O.E. duhet të sigurojë nuk ka me shume se tri kontrata aktive me MKRS-ne të natvres së njëitë, respektivisht në	7.Nëse vlera e kontratës në të cilën stafi i licencuar është i angazhuar ka vlerë nën 100,000.00 euro ky kriter nuk zbatohet. Nëse O.E. konkurron në disa projekte restauruese në planin dinamik të punës

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “G-PROJECT”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Prizrenit LOT I Shkolla e mesme Ryzhdiye në Prizren dhe LOT II Shkolla e vjetër e fshatit Mushnikovë” me numër të prokurimit: “207-25-9810-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK

		planin dinamik të punës nuk mund të jetë i njëjti arkitekt i licencuar ose mjeshtër i licencuar i angazhuar në më shumë se tri kontrata tjera të natyrës së njëjtë. Të gjitha kërkesat e paraqitura vlejnë për të dy (2) LOT- et, me përjashtim të kërkesës me nr. 1 të pikës 8.1& 8.2 të Kapacitetit ekonomik dhe financiar Vërejtje: Nese OE apo GRO ofertojnë në të dy LOT- et ofertimi duhet të bëhet sipas rregullave të nenit 18.5 dhe 18.9 të Rregullores nr. 002/ 2024 për Prokurimin Publik	nuk mund të figurojë i njëjti arkitekt i licencuar, ose mjeshtër i licencuar në më tepër se tri kontrata i angazhuar në të njëjtën kohë (njëjtat data kalendarike).
--	--	---	--

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “G-PROJECT”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Prizrenit LOT I Shkolla e mesme Ryzhdije në Prizren dhe LOT II Shkolla e vjetër e fshatit Mushnikovë” me numër të prokurimit: “207-25-9810-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK



Republika e Kosovës / Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth & Sports
NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES
 Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:

Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Prizrenit LOT I Shkolla e mesme Ryzhdije në Prizren dhe LOT II Shkolla e vjetër e fshatit Mushnikovë

Nr. i prokurimit	207-25-9810-5-1-1
Nr. i brendshëm	207-25-115-5-1-1

LOT I: Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Prizrenit LOT I Shkolla e mesme Ryzhdije në Prizren

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës	Statusi
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik TONI O.P.; N.N. 100 % Design Sh.p.k. Karvasari, Malishevë	623,717.70 EUR	I SUKSESSHËM
2.	G-PROJECT - RR.BESIM SHALA PN, PRIZREN	633,448.60 EUR	I PASUKSESSHËM
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik: "ALBI COMPANY" SH.P.K; „Raf II"sh.p.k. Sylejman Vokshi pn, RAHOVEC	647,926.30 EUR	I PASUKSESSHËM
4.	ALPING SH.P.K. - Bil.6, Obj.II, Kalabri, Prishtine	668,482.00 EUR	I PASUKSESSHËM

LOT II: Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Prizrenit LOT II Shkolla e vjetër e fshatit Mushnikovë

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës	Statusi
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik TONI O.P.; N.N. 100 % Design Sh.p.k. Karvasari, Malishevë	271,326.50 EUR	I SUKSESSHËM
2.	G-PROJECT - RR.BESIM SHALA PN, PRIZREN	284,461.00 EUR	I PASUKSESSHËM
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik: "ALBI COMPANY" SH.P.K; „Raf II"sh.p.k. Sylejman Vokshi pn, RAHOVEC	277,441.50 EUR	I PASUKSESSHËM
4.	ALPING SH.P.K. - Bil.6, Obj.II, Kalabri, Prishtine	286,335.00 EUR	I PASUKSESSHËM

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Ministria e Kultures Rinise dhe Sportit, Nëna Terezë nr. 35 – Prishtinë, pas aprovimit të buxhetit – shpërblen me kontratë:

LOT I	Grup i Operatorëve Ekonomik TONI O.P.; N.N. 100 % Design Sh.p.k. Karvasari, Malishevë	623,717.70 EUR
LOT II	Grup i Operatorëve Ekonomik TONI O.P.; N.N. 100 % Design Sh.p.k. Karvasari, Malishevë	271,326.50 EUR

Kanë ofertuar në LOT I dhe LOT II katër (4) OE/GOE me oferta të ndryshme;

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

///

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - G-PROJECT

Aktiviteti i prokurimit me titull: “**Nderhyrje restauruese dhe konservuese ne asetet e Trashegimise Kulturore ne Rajonin e Prizrenit LOT I Shkolla e mesme Ryzhdije ne Prizren dhe LOT II Shkolla e vjeter e fshatit Mushnikove**” me nr. të prokurimit: “**207-25-9810-5-1-1**”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar kundër Vendimit B58 të Autoritetit Kontraktues.

OE ankues është shpallë i pasuksesshëm me çmimin më të lartë se sa Grupi i Operatorëve të Rekomanduar.

Tutje OE ankues pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, i njëjti parashtron ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK nuk ka vlerësuar drejtë dhe se gjatë vlerësimit shkelë Ligjin e Prokurimit Publik përkatësisht nenet: 6,7,10,11,59,70, Rregulloren për Prorkuim Publik nr 001/2022 neni 7 dhe nenet: 47,48, dhe 52 të Ligjit për Procedurën Administrative.

OE ankues në ankesë ka parashtruar pretendime ankimore kundër grupit të rekomanduar për këtë aktivitet të prokurimit. I njëjti pretendon se AK nuk ka dhënë qasje të plotë në ofertë, të cilëve ju është pa mundur të vërtetojnë përgjegjshëmrinë grupit të rekomanduar, dhe si e

tillë, në mungesë të qasjes së plotë të njejtut pretendojnë se grupi i rekomanduar nuk i plotësojnë kërkesat e dojes së tenderit duke dyshuar se grupit i mungojnë, ISO standardet, deklaratat nga antari i konzorciumit duke kontestuar Marrëveshjen e Konzorciumit, gjithashtu ka kërkuar nga AK që të verifikohen edhe kontratat e tjera që kanë grupi i rekomanduar me MKRS, duke u siguruar që nuk kanë po të njejtin staf të angazhuar.

(Shënim: *Të gjitha pretendimet ankimore gjenden të përshkruara lartë tek pjesa Dispozitat e Shkelura dhe Pretendimet Ankimore*)

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, në ofertën e grupit të rekomanduar gjenden dy kërkesa Ankes 3 në të cilat kërkohet që të klasifikohen si dokumente sekrete afariste me qëllim që të mos dëmtohet interesi material i interesave legjitime komerciale, duke ju shkaktuar dëme financiare, rënje të integritetit, dëmtim të reputacionit, keqpërdorim të dokumenteve etj. Dhe rrjedhimisht, AK konform nenit 10 dhe 11 të LPP-së, ka klasifikuar dokumentet të cilat janë konform kërkesës sipas nenit 68 dhe 69, ndërsa sa i përket ISO standardeve, përkundër që nuk mund të quhet si sekret afarist, AK ka konsideruar si sekret për faktin se kanë qenë pjesë e kërkesës në 9.1&9.2 të nenit 69 të LPP-së.

Mirëpo, sa i përket dyshimit për ISO standard ekspertja mund të konstatoj se të njejtat gjenden në ofertë për dy operatorët ekonomik, valide dhe janë konfirmuar sipas QR Code, andaj **pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar**.

Tutje, lidhur me Marrëveshjen e konzorciumit, ne ofertën e OE ankues gjendet marrëveshja e konzorciumit sipas formularit standard të bashkangjitur nga AK në DT, në të cilën formular janë të përcaktuar lideri dhe antari i konzorciumit me përqindjen 90% me 10 %, në të cilën janë përshkruar edhe përgjegjësitë në formë gjenerale e cila sipas përqindjes nënkupton pjesëmarrjen në realizim të kontratës, dhe nuk mund të konsiderohet se bie ndesh me formularin, si e tillë **pretendimi i OE ankues nuk gjendet i qëndrueshëm**.

OE ankues gjithashtu përmënd si dyshime se, Grupi i rekomanduar posedojnë disa kontrata aktuale me AK-në, i cili dyshon se nuk e plotësojnë kërkesën numër 7 në dosje të tenderit, për arsye se mund të jenë stafi i njejtë në disa kontrata. Të cilin pretendim Ekspertja shqyrtuese shpjegon se, AK në DT ka kërkuar:

Kriteri numër 7. O.E. duhet të siguroj nuk ka me shume se tri kontrata aktive me MKRS-ne të natyrës së njëjtë, respektivisht në planin dinamik të punës nuk mund të jetë i njëjti arkitekt i licencuar ose mjeshtër i licencuar i angazhuar në më shumë se tri kontrata tjera të natyrës së njëjtë.

7.Nëse vlera e kontratës në të cilën stafi i licencuar është i angazhuar ka vlerë nën 100,000.00 euro ky kriter nuk zbatohet. Nëse O.E. konkurron në disa projekte restauruese në planin dinamik të punës nuk mund të figurojë i njëjti arkitekt i licencuar, ose mjeshtër i licencuar në më tepër se tri kontrata i angazhuar në të njëjtën kohë (njëjtat data kalendarike).

Të cilin pretendim, meqë ekspertja nuk ka qasje në ofertat e aktiviteteve të kaluara, si e tillë, konsideron se AK mbanë përgjegjësinë e verifikimit të ofertave dhe listave të stafit, për cilat vlenë të theksohet se kriteri është për projektet mbi 100K, andaj sipas konstatimit të AK-së në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim, të njëjtut kanë verifikuar këto dyshime dhe nuk gjenden të bazuara.

Si përfundim, Autoriteti Kontraktues vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertave ka analizuar konform nenit 1, 6, 7, 59, 72 të LPP-së, duke rezultuar me rekomandim të ofertës sipas kriterit çmimi më i ulët i përgjegjshëm, ndërsa sa i përket mos dhënies së qasjes së plotë nga AK për OE ankuesin, ekspertja shqyrtuese konsideron se, bazuar në paragrafi 3 përkatësisht 3.1, 3.2, dhe 3.3 të nenit 11 të LPP-së, sipas kërkesës në Ankes 3 për Sekrete Afariste nga OE i rekomanduar, AK ka respektuar nenin 11 paragrafi 4 duke dorëzuar një verzion të pastruar të dokumenteve, dhe rrjedhimisht meqë dokumentet e kërkuara janë kërkesat sipas nënit 68 dhe 69, atëherë, ankesa e OE ankues është trajtuar nga eksperti shqyrtues me qasjen në E-Prokurim konform nenit 10 paragrafi 8 i LPP-së.

Andaj, ankesa e OE ankues rekomandohet që të aprovohet pjesërisht e bazuar për faktin se, në mungesë të qasjes i njëjti dyshon se AK nuk ka vlerësuar drejtë dhe se dokumentet e Grupit të rekomanduar nuk janë ofruar sipas kërkesave të DT-së, mirëpo sipas shqyrtimit të shkresave të lëndës rezulton se grupi i rekomanduar plotëson kërkesat dhe dyshimet e OE ankues nuk qëndrojnë, si e tillë rekomandohet që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “G-PROJECT”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Prizrenit LOT I Shkolla e mesme Ryzhdiqe në Prizren dhe LOT II Shkolla e vjetër e fshatit Mushnikovë” me numër të prokurimit: “207-25-9810-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **G-PROJECT**



Blerina Huruglica